UDHËZIM
Nr. 22, datë 25.8.2025

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 14.1.2020, "PËR DOKUMENTACIONIN DHE PROCEDURAT PËR HAPJEN, RIORGANIZIMIN DHE MBYLLJEN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË, DEGËVE TË TYRE, NJËSIVE KRYESORE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT, SI DHE PËR NDARJEN OSE BASHKIMIN E INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 30 dhe 35 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; vendimit nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar; vendimit nr. 418, datë 10.5.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe degëve të tyre", të ndryshuar; dhe të urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, "Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të arsimit dhe sportit, znj. Ana Kapaj", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimet si më poshtë:

a) Kudo në përmbajtje të udhëzimit, togfjalëshi "*Ministria e Arsimit dhe Sportit"* të zëvendësohet me togfjalëshin *"Ministria përgjegjëse për arsimin*".

b) Pika 1 e kreut I/B ndryshon si më poshtë:

"*1. Institucioni i arsimit të lartë ngarkon aplikimin në platformën e-Albania, për riorganizimin e IAL-së, sipas formularit përkatës në platformën e-Albania, brenda datës 30 dhjetor për vitin akademik pasardhës, i cili shqyrtohet në MAS".*

c) Pas kreut IV shtohet kreu IV/1, me përmbajtje si më poshtë:

"KREU IV/1
PROCEDURA E SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE DHE TË ANKIMIMEVE

Mbi bazën e aplikimeve në platformën e-Albania, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë në ministrinë përgjegjëse për arsimin, vlerësojmë aplikimet dhe ankimimet, sipas përgjegjësive më poshtë:

1. Për të gjitha aplikimet e përcaktuara në këtë udhëzim, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat shqyrton dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, sipas formularëve të kërkesave në e-Albania për aspektet e përputhshmërisë ligjore.

2. Për të gjitha aplikimet e përcaktuara në këtë udhëzim struktura përgjegjëse për arsimin e lartë shqyrton aspektet përmbajtjesore të cilësisë së aplikimit, që lidhen me vlerësimin mbi nevojat e tregut, përputhshmërinë e kritereve dhe të standardeve të cilësisë, të kërkuara me ato të aplikimit. Sipas vlerësimit, struktura përgjegjëse për arsimin e lartë mund të kërkojë informacione plotësuese mbi aspekte që lidhen me aplikimin brenda afateve të përcaktuara.

3. Struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat njofton subjektin për vlerësimin e aplikimit, pas vlerësimit të strukturës përgjegjëse për arsimin e lartë, sipas afateve të përcaktuara për secilën procedurë.

4. Struktura përgjegjëse për lejet dhe për licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë i propozojnë autoritetit përkatës ekspertët e jashtëm, nga lista e ASCAL-së.

5. Pas vlerësimit përfundimtar pozitiv nga ekspertët e jashtëm, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë, i propozojnë autoritetit përkatës aktin sipas aplikimit të subjektit.

6. Në rastet e paraqitjes së ankimimeve, struktura përgjegjëse për lejet dhe licencat dhe struktura përgjegjëse për arsimin e lartë, në bashkëpunim me strukturat juridike ndjekin procedurat e shqyrtimit të ankimimeve, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi."

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Ana Kapaj